

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Euro 4 Construction” Shpk

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar :

Sot, më datë 02.03.2022 ne themeluesit kemi krijuar, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “Euro 4 Construction” Shpk, me **Ortakë**, shtetasit:

1. Z. Mondi Rifat Hidri i datëlindjes 17.05.1975, lindur në Elbasan dhe banues në Rruga Veli Xhymerti, 00690856, Nd.6, Ap. 22, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me Letërnjoftim (ID) me numër 037043153 dhe me numër personal, H50517069T;

2. Z. Ilir Servet Memko i datëlindjes 09.03.1986, lindur në Tiranë, banues në Rruga Martin Camaj, Nd. 353, H.1, Rrashbull, Arapaj, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me Letërnjoftim (ID) me numër 36741524 dhe me numër personal, I60309086L

Shoqëri e cila do të funksionojë në bazë të këtij, **AKT-THEMELIMI**.

LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË

NENI 1

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është “Euro 4 Construction” Shpk.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 2

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare “Euro 4 Construction” Shpk, e ka vendodhjen e saj në, Rruga Pavaresia, Lagjia Nr. 13, Nr. Pasurie 46/143, Zk. 8518, Plazh, Nr. 13, Kati i Parë, Sip. 33.06 M², Durrës.

REGJIMI JURIDIK

NENI 3

Shoqëria është shqiptare me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria “Euro 4 Construction” shpk personalitetin juridik në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 4

Objekt i Shoqërisë Tregtare "Euro 4 Construction" Shpk është :

Veprimtari në fushën e ndërtimit, investitor në ndërtim, investime strategjike. Ndërtues i objekteve civile industriale, turistike, bujqësore, ndërtimi i ndërtesave, serave, zyrave, rrugëve, hekurudhave, porteve, aeroporteve, veprave energjitike, kanalizimeve dhe çdo vepre tjetër me qëllim ndërtimi. Restaurimi dhe riparimi i godinave dhe objekteve të ndryshme civile. Punime dheu e transport, lidhje hekuri ndërtimi, punime murature, betoni, beton armeje, kontruksione të ndryshme metalike e druri. Punime rrugësh, kanalizimeve, ujesjellësa, urash e veprash arti. Tregtimin me pakicë dhe shumicë e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikante, karburanteve, lëndëve djegëse. Bar-Kafe-Restorant. Furre buke, prodhim dhe tregtim buke. Thertore. Dhënie me qira të apartamenteve e ambjenteve të shërbimit, dhenie me qira të mjeteve të transportit dhe transport për të tretë. Autolarje, autovetura, kamionë, interior etj. Shërbime në fushën e turizmit, restorante, hoteleri, agjensi udhëtimi, sporte ujore, lundrime turistike, stacione plazhi etj. Import-eksport i mallrave të ndryshëm ushqimore dhe industriale si dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i tyre. Prodhime inerte prej betoni dhe tregtimi tyre. Veprimtari në fushën e transportit, magazinimit, përpunimit, prodhimit e tregtimit me shumicë e pakicë, Import-Eksport, brenda e jashtë vendit i mallrave të të gjitha llojeve, ushqimore e industrial, prodhime bujqësore e blegtorale, fruta-perime e pije freskuese e alkoolike, materiale e lëndë ndërtimi, pajisje e makineri, elektroshtepiake, hidrosanitare, elektrike e hidraulike, dyqane reklamash, shërbime postare etj.

KOHËZGJATJA

NENI 5

Shoqëria Tregtare "Euro 4 Construction" Shpk, do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "Euro 4 Construction" Shpk, përbëhet prej 100,000.00 (njëqindmijë) lekë.

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e:

1. **Z. Mondi Rifat Hidri:** Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. **Z. Ilir Servet Memko:** Zotërues 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) lekë.



ADMINISTRIMI

NENI 7

Administrator i Shoqërisë i emëruar është Z. Mondi Rifat Hidri me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

TË DREJTAT E SHOQËRISË

NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur. Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 9

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

SHPËRNDARJA E FITIMIT

NENI 10

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

LIKUJDIMI

NENI 11


Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "shoqëri në likujdim e sipër". Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa verejtje.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Euro 4 Construction" Shpk

Mondi Rifat Hidri





Illir Servet Memko

